



BANKA QENDRORE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS  
CENTRALNA BANKA REPUBLIKE KOSOVA  
CENTRAL BANK OF THE REPUBLIC OF KOSOVO

# Anketa e Kreditimit Bankar në Kosovë

Numër 20

BANKA QENDRORE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS  
CENTRALNA BANKA REPUBLIKE KOSOVA  
CENTRAL BANK OF THE REPUBLIC OF KOSOVO

# Anketa e Kreditimit Bankar në Kosovë dhe Pritjet për Inflacionin

(TM2 2024 dhe pritjet për TM3 2024)

Numër 20

**BOTUES**

© Banka Qendrore e Republikës së Kosovës

Departamenti i Analizave Ekonomike  
dhe i Stabilitetit Financiar

33 Garibaldi, Prishtinë 10000

Tel: ++383 38 222 055

Fax: ++383 38 243 763

**Faqja e internetit**

[www.bqk-kos.org](http://www.bqk-kos.org)

**Adresa elektronike**

[economic.analysis@bqk-kos.org](mailto:economic.analysis@bqk-kos.org)

## Përmbajtja

<b>Anketa e Kreditimit Bankar në Kosovë (AKBK)</b>	<b>4</b>
<b>Hyrje</b>	<b>4</b>
Përmbledhja e rezultateve	4
<b>Kutia 1. Metodologjia</b>	<b>7</b>
<b>Zhvillimet në standardet kreditore, në kushtet dhe rregullat kreditore, si dhe në kërkesën për kredi</b>	<b>7</b>
<b>Kreditë ndaj ndërmarrjeve</b>	<b>8</b>
Standardet kreditore	8
Kushtet dhe rregullat	8
Kërkesa për kredi	9
<b>Kreditë ndaj ekonomive familjare</b>	<b>10</b>
Standardet kreditore	10
Kushtet dhe rregullat	11
Kërkesa për kredi	11
Financimi	12
Rezultatet e pyetjeve të fokusuara	13
<b>Pritjet për Inflacionin</b>	<b>13</b>
Metodologjia	14
Përmbledhja e rezultateve	14

## Anketa e Kreditimit Bankar në Kosovë (AKBK)

### Hyrje<sup>1</sup>

Me qëllim të rritjes së kapaciteteve analitike për një vlerësim sa më të mirë të dinamikave të kreditimit në Kosovë dhe pritjeve për zhvillimet në nivelin e çmimeve, Banka Qendrore e Republikës së Kosovës (BQK) ka dizajnuar dhe realizuar një anketë me bankat komerciale që operojnë në tregun bankar në Kosovë. Raporti që do të analizoj rezultatet e këtij anketimi, do të publikohet në frekuencë tremujore në web-faqen e BQK-së, me qëllim që të ofrojë një pasqyrë më të gjerë rreth perceptimit të rrezikut të bankave dhe gatishmërinë e bankave për të dhënë hua, si dhe, sjelljes së ekonomive familjare dhe ndërmarrjeve kundrejt dinamikave në kreditim, si pasojë. Ky raport evidenton sjelljen kreditore për periudhën e tremujorit të dytë të vitit 2024, dhe pritjet e bankave për dinamikat në kreditim për tremujorin e tretë të vitit 2024.

Përveç pyetjeve standarde, kjo anketë është plotësuar me katër pyetje shtesë në përpjekje për të identifikuar rreziqet aktuale dhe më evidente të sektorit bankar, si dhe zberthimin e orientimit të ofertës dhe kërkesës kreditore të disagreguar sipas sektorëve ekonomik.

### Përmbledhja e rezultateve<sup>2</sup>

Në gjysmën e parë të vitit, stoku i kredive shënoi një rritje dyshifrore, megjithëse me një ngadalësim të lehtë krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar. Sipas të dhënave, kreditë e reja të lëshuara nga sektori bankar gjatë periudhës janar-qershor 2024 shënuan një rritje vjetore dukshëm më të lartë se në të njëjtën periudhë të vitit të kaluar. Kjo rritje ishte e theksuar në tremujorin e parë të vitit, ndërsa në tremujorin e dytë, rritja e kredive të reja u ngadalësua.

**Sipas rezultateve të Anketës, dinamikat në aktivitetin kreditor, për tremujorin e dytë të vitit, u ndikuan në masë më të madhe nga kërkesa kreditore, ndërkohë që oferta kreditore kishte ndryshime marginale.** Për tremujorin e ardhshëm të tretë, bankat presin që aktiviteti kreditor të vazhdoj të jetë e mbështetur nga kërkesa kreditore në rritje, por me ndikim më të ulët se në tremujorin e dytë, ndërkohë që oferta kreditore pritet të jetë më e shtrënguar.

**Për segmentin e ndërmarrjeve,** bankat raportuan se dinamika e kreditimit u përcaktua kryesisht nga kërkesa kreditore, përderisa oferta kreditore për këtë segment kishte ndryshime marginale. Bankat aplikuan standarde kreditore të lehtësuara deri në një masë për NVM-të, kurse për ndërmarrjet e mëdha kishte ndryshime marginale negative (tabela 1). Përderisa mbështetja nga FKGK dhe ulja e kërkesës për kolateral kishin ndikim pozitiv në standardet kreditore për segmentin e ndërmarrjeve, pozita e likuiditetit të bankave, kufizimet në kapitalin e bankave që operojnë në vend si dhe qasja më e kujdesshme ndaj rrezikut ishin ndër faktorët kryesor që ndikuan në shtrëngim marginal të standardeve kreditore. Për tremujorin e tretë të vitit 2024, pritjet e bankave për standardet kreditore pritet të mbesin të ngjashme, më konkretisht më të shtrënguara, me ato të aplikuara përgjatë tremujorit të dytë të vitit 2024, si për NVM-të ashtu dhe për ndërmarrjet e mëdha (tabela 1). Në këtë rast, pozita e likuiditetit të bankave dhe cilësia e portfolios kreditore (ecuria e kredive me probleme) mund të kenë potencial shtrëngues, por në nivele marginale. Megjithatë, përkrahja nga FKGK dhe perspektiva më pozitive e bankave vendore pritet të kenë efekt lehtësues në standardet kreditore.

<sup>1</sup> Për informata më të detajuara rreth qëllimit dhe historikut të anketës së kreditimit bankar në BQK, shikoni publikimin "Anketa e Kreditimit Bankar dhe Pritjeve të Inflacionit" Nr. 1.

<sup>2</sup> Pyetëtori dhe seria kohore e rezultateve të AKBK-së janë në dispozicion në faqen e internetit të BQK-së, nën vegzën e Anketës së Kreditimit Bankar.

**Kushtet dhe rregullat e aplikuara nga bankat me rastin e dhënies së kredive për ndërmarrjet** në përgjithësi mbetën të pandryshuara për të dy kategoritë e ndërmarrjeve. Faktorët ndikues në lehtësimin e kushteve dhe rregullave si për NVM-të ashtu dhe për ndërmarrjet e mëdha ishin kërkesa më e ulët për kolateral si dhe lehtësimi marginal në madhësinë e kredisë së lejuar për ndërmarrjet e mëdha (rritje të shumës së mestarë të kredisë), mbështetja nga FKGK-ja si dhe norma në rënie e Euribor. Sa i përket pagesave tjera, përveç normës së interesit (tarifave dhe komisioneve të ndryshme), ato mbetën të pandryshuara si për NVM-të ashtu edhe për ndërmarrjet e mëdha. Ndërsa faktorët ndikues në shtrëngimin e kushteve dhe rregullave të aplikuara duke neutralizuar kështu efektin e tyre në standardet e përgjithshme të aplikuara kreditore, ishin kufizimet në qasje për kapital nga bankat amë dhe bankat e tjera, cilësia e portfolios kreditore, dhe perspektiva në tregjet globale.

Në tremujorin e ardhshëm, në përgjithësi, kushtet dhe rregullat e aplikuara nga bankat pritet të mbeten kryesisht të ngjashme me tremujorin aktual, me përjashtim të kërkesave për kolateral të cilat pritet të mbesin të pandryshuara. Kufizimet në kapitalin e bankave vendore, pozita e likuiditetit të bankave si dhe perspektiva e tregjeve globale janë specifikuar si faktor që mund të ndikojnë negativisht kushtet dhe rregullat e kreditimit gjatë tremujorit të ardhshëm, faktorë të cilët priten të neutralizohen nga konkurrenca dhe mbështetja prej FKGK-së.

Në tremujorin e dytë të vitit 2024 u raportua për rritje të lartë të **kërkesës për kredi nga ndërmarrjet**, si për NVM-të ashtu edhe ndërmarrjet e mëdha. Në përgjithësi, rritja e kërkesës për kredi, sipas deklarimeve të bankave, u nxit kryesisht nga rritja e kërkesës për financim të inventarit dhe kapitalit punues dhe investimeve fikse. Në tremujorin vijues, pritet rritje deri në një masë të kërkesës për kredi si nga NVM-të ashtu dhe nga ndërmarrjet e mëdha. Rritja më e ngadalësuar e kërkesës për kredi pritet të atribuohet kryesisht nivelit të kërkesës për financim të investimeve fikse, e në masë më të ulët nivelit të kërkesës për financim të inventarit dhe kapitalit punues.

**Aktiviteti kreditues ndaj ekonomive familjare** ka vazhduar të zgjerohet me ritëm të lartë në TM2 2024, mbështetur kryesisht nga **kërkesa më e lartë, por edhe nga oferta e favorshme kreditore**. Standardet kreditore u lehtësuan deri në një masë për kreditë konsumuese dhe ato për blerje të shtëpive. Faktorët që ndikuan në lehtësim të standardeve kreditore përgjatë TM2 2024 ishin konkurrenca ndërbankare, perspektiva pozitive në tregun vendor dhe rritja e besueshmërisë ndaj kredimarrësve. Në tremujorin e tretë të vitit 2024, standardet kreditore të aplikuara nga bankat pritet të jenë më të shtrënguara, duke e ndikuar kryesisht segmentin e kredive konsumuese (tabela 1). Standarde më të shtrënguara kreditore priten të jenë kryesisht të ndikuara nga rritja potenciale e kredive me probleme.

Në përgjithësi, kushtet dhe rregullat për kreditë e reja për ekonomitë familjare u lehtësuan deri në një masë gjatë tremujorit të dytë të vitit 2024. Rezultatet tregojnë lehtësim në shumën mesatare të kredisë, kurse lehtësim deri në një masë në maturitetin e kredisë dhe kërkesës për kolateral, si për kreditë për blerje të shtëpive ashtu edhe për ato konsumuese. Bankat deklaruan se në lehtësimin e kushteve dhe rregullave për kreditë e reja ndikuan konkurrenca nga bankat tjera, perspektiva pozitive e bankave në vend dhe besueshmëria e kredimarrësve. Për tremujorin e tretë të vitit 2024, bankat presin që kushtet dhe rregullat për kreditë e reja të mbeten të pandryshuara.

**Në anën e kërkesës, kërkesa për kredi nga ekonomitë familjare** shënoi rritje të lartë në tremujorin e dytë të vitit 2024, ku ajo për kredi konsumuese rezultoi të ishte më e lartë se për kreditë për blerje të shtëpive. Sipas bankave, rritja e kërkesës për kredi konsumuese u ndikua nga nevoja për financimin e shpenzimeve të konsumit dhe besimi më i lartë i konsumatorëve, i nxitur nga perspektiva më optimiste makroekonomike. Ndërkohë, perspektiva e tregut të patundshmërive ka kontribuar në rritjen e kërkesës për kreditë për blerje të pasurive të patundshme. Në tremujorin e tretë të vitit 2024, bankat presin rritje të kërkesës për kredi nga ekonomitë familjare, në nivel të ngjashëm me atë aktual (tabela 1). Kjo rritje pritet të nxitet kryesisht nga kërkesa për kreditë konsumuese, që përbëjnë pjesën më të madhe të gjithsej kredive për ekonomitë familjare, e ndikuar nga besueshmëria ndaj

konsumatorëve dhe nevoja për financim të shpenzimeve tjera familjare. Gjithashtu, pritjet rritje të kërkesës, por në nivel më të ulët, edhe për kreditë për blerje të shtëpive, e mbështetur nga pritshmëritë për perspektivë të favorshme në tregun e patundshmërive.

**Tabela 1. Vlerësimi i bankave për ndryshimet në ofertën dhe kërkesën kreditore**

	Oferta (Standardet kreditore)		Kërkesa	
	TM2 2024	TM3 2024 (pritjet)	TM2 2024	TM3 2024 (pritjet)
<b>Ndërmarrjet</b>	➔	➔	⬆️	➔
NVM	➔	➔	⬆️	➔
Ndërmarrjet e mëdha	➔	➔	⬆️	➔
<b>Ekonomitë familjare</b>	➔	➔	⬆️	⬆️
Kredi për blerjen e shtëpive	➔	➔	⬆️	⬆️
Kredi konsumuese	➔	➔	⬆️	⬆️

⬆️	Lehtësim i standardeve kreditore/Rritje e kërkesës për kredi (indeks pozitiv mbi 0.20)
➔	Lehtësim i standardeve kreditore/Rritje e kërkesës për kredi (indeks pozitiv nën 0.20)
➔	Kryesisht pandryshime (indeks pozitiv/negativ deri 0.05)
➔	Shtërngim i standardeve kreditore/Rënie e kërkesës për kredi (indeks negativ nën 0.20)
⬆️	Shtërngim i standardeve kreditore/Rënie e kërkesës për kredi (indeks negativ mbi 0.20)

Burimi: BQK.

Në tremujorin e dytë të vitit 2024 bankat aplikuan qasje dukshëm më lehtësuese në vlerësimin e aplikacioneve të reja, veçanërisht për kreditë konsumuese për ekonomitë familjare dhe për kreditë për ndërmarrjet e vogla të mesme (NVM). Ky lehtësim në shqyrtim të aplikacioneve të reja ishte më i dukshëm për kreditë me maturitet afatgjatë për të dy segmentet (ndërmarrje dhe ekonomi familjare), ndërsa për kreditë me maturitet afatshkurtër, bankat ishin më të kujdesshme për të dy segmentët. Në tremujorin e tretë të vitit 2024, bankat kanë paraparë qasje më të shtërnguar në vlerësim të aplikacioneve të reja për kredi, si për ekonomitë familjare (konsumuese dhe për blerje të shtëpive) ashtu dhe për ndërmarrjet (NVM-të dhe ndërmarrjet e mëdha).

Qasja në financim nga bankat gjatë tremujorit të dytë të vitit 2024 rezultoi më e ulët krahasuar me tremujorin paraprak. Bankat deklaruan rritje më të ulët të financimit, pavarësisht rritjes së depozitave nga ekonomitë familjare. Bankat gjithashtu deklaruan rënie të financimit nga depozitat e ndërmarrjeve dhe nga tregu i parasë ndërbankare. Sa i përket maturitetit, bankat deklaruan rritje më të ngadalësuar të burimeve të financimit afatshkurtër, ndërsa rritje më të lartë të financimit afatgjatë (mbi një vit). Gjatë tremujorit të ardhshëm, në përgjithësi bankat presin rritje dukshëm më të lartë të financimit, ndikuar kryesisht nga rritja e pritjet e depozitave nga të dy segmentet, ekonomitë familjare dhe ndërmarrjet. Gjithashtu pritjet rritje e financimit me maturitet afatshkurtër, ndërsa financimi afatgjatë pritet të mbetet i pandryshuar.

## Kutia 1. Metodologjia

### Pyetësi i Anketës së Kreditimit Bankar në Kosovë

Pyetësi i AKBK është i bazuar në forma të standardizuara të pyetësorëve të përdorur nga Bankat Qendrore të vendeve të eurozonës dhe më gjerë. Megjithatë, pyetësi i BQK për AKBK është modifikuar dhe përshtatur ashtu që të paraqes në mënyrën më të mirë dhe më gjithëpërfshirëse zhvillimet e kreditimit në sektorin bankar në Kosovë.

Pyetësi i AKBK përbëhet nga 19 pyetje, të cilat mbulojnë ndryshimet në ofertën dhe kërkesën për kredi, faktorët që kontribuojnë në këto ndryshime si dhe qasjen në financim të sektorit bankar, në baza tre mujore. Pyetjet mbi kreditimin bankar fokusohen në dy kategori kryesore: (i) kreditë ndaj ndërmarrjeve, dhe (ii) kreditë ndaj ekonomive familjare. Për më tepër, kreditë ndaj ndërmarrjeve nën-kategorizohen në kreditë ndaj NVM-ve dhe kreditë ndaj ndërmarrjeve të mëdha, përderisa kreditë ndaj ekonomive familjare nën-kategorizohen në kreditë për blerjen e shtëpive dhe kreditë konsumuese. Për të gjitha kategoritë e lartpërmendura, ndryshimet në ofertën kreditore përcaktohen nga standardet kreditore të aplikuara gjatë aprovimit të kredive, kushtet dhe rregullat e aplikuara për kreditë e reja, norma e aprovimit të kredive, si dhe faktorët që ndikojnë në ndryshimet e tyre. Ndërsa, ndryshimet në kërkesën për kredi përcaktohen nga kërkesa për kredi (numri i aplikacioneve për kredi), cilësia e aplikacioneve të pranuar për kredi, si dhe faktorët që e ndikojnë kërkesën për kredi. Pyetjet e anketës kryesisht janë të formuluar për ndryshimet gjatë tre muajve paraprak dhe pritjet për tre muajt e ardhshëm. Gjithashtu, pyetjet mbulojnë kreditë edhe në aspekt të maturimit të tyre dhe valutës në të cilën lëshohen.

Përveç pyetjeve standarde, pyetësi i AKBK mund të përmbajë edhe pyetje shtesë mbi çështje specifike me interes për shpjegimin e zhvillimeve në sektorin bankar. Përderisa pyetjet standarde mbulojnë një periudhë tre-mujore, pyetjet shtesë mund t'i referohen ndryshimeve gjatë një periudhe kohore më të gjatë. Në anketim marrin pjesë dhjetë nga dymbëdhjetë bankat që operojnë në Kosovë. Rrjedhimisht, bankat pjesëmarrëse përfaqësojnë tregun e përgjithshëm bankar dhe sigurojnë një përfaqësim të duhur statistikor, duke marrë parasysh se ato përfaqësojnë rreth 98 përqind të aseteve të gjithsej sektorit bankar dhe 99.1 përqind të gjithsej kreditimit në sektorin bankar.

Pjesëmarrësve të anketës u kërkohet të tregojnë në mënyrë cilësore intensitetin e çdo shtrëngimi ose lehtësimi si dhe intensitetin e çdo ulje ose rritje, duke raportuar ndryshimet përmes pesë shkallëve si: (i) shtrënguar / ulur në nivel të konsiderueshme, (ii) shtrënguar / ulur në një masë, (iii) e pandryshuar, (iv) lehtësuar / rritur në një masë ose (v) lehtësuar / rritur në nivel të konsiderueshme.

### Gjenerimi i rezultateve të anketës së kreditimit bankar

Kuantifikimi i përgjigjeve të marra nga bankat individuale dhe agregimi i tyre për të paraqitur ndryshimet në nivel sektori arrihet përmes gjenerimit të një indeksi. Ky indeks gjenerohet për çdo kategori e nën-kategori të secilës pyetje, duke dhënë në këtë mënyrë një njësi kuantifikuese për përgjigjet e marra në nivel të sektorit. Fillimisht, përgjigjeve u përcaktohet një vlerë në bazë të intensitetit të ndryshimeve, konkretisht përgjigjeve ku bankat kanë deklaruar shtrëngim/ulje të konsiderueshme u përcaktohet vlera - 1, vlerë dyfish më e madhe se sa ajo e përcaktuar për përgjigjet kur bankat deklarojnë shtrëngim / ulje deri në një masë (vlerë prej -0.5). Ngjashëm, përgjigjet kur kemi lehtësim/rritje të konsiderueshme kanë vlerë 1, përderisa ato me lehtësim/rritje deri në një masë u përcaktohet vlera 0.5. Rezultatet po ashtu janë të peshuara në bazë të pjesëmarrjes së bankave në gjithsej kreditimin e sektorit bankar. Përfundimisht, pesha e secilës bankë sipas pjesëmarrjes në tregun e kredive shumëzohet me vlerën e përcaktuar në bazë të intensitetit të përgjigjes së dhënë, duke fituar indeksin në fjalë. Më tutje, agregimi i indeksit në nivel sektori bëhet përmes shumëzimit të indekseve të fituara për secilën bankë. Vlerat e indeksit janë në intervalin -1 dhe 1, ku vlerat pozitive të indeksit paraqesin lehtësim, rritje apo kontribut pozitiv ndërsa vlerat negative paraqesin shtrëngim, rënie apo kontribut negativ.


## Zhvillimet në standardet kreditore, në kushtet dhe rregullat kreditore, si dhe në kërkesën për kredi

### Kreditë ndaj ndërmarrjeve

#### Standardet kreditore

Gjatë tremujorit të dytë të vitit 2024, rezultati për standardet kreditore (politikat kreditore) të aplikuara për ndërmarrjet, në përgjithësi, ishte në linjë me deklaratat në anketën e kaluar (TM1 2024). Oferta kreditore në tremujorin e dytë të vitit 2024 kishte ndryshime marginale (grafiku 1).

Grafik 1. Ndryshimet në standardet kreditore të aplikuara për ndërmarrjet dhe faktorët që kontribuan



Në kuadër të kategorive të ndërmarrjeve, bankat deklaruan standarde kreditore të shtrënguara marginalisht për ndërmarrjet e mëdha, ndërsa lehtësim deri në një masë për NVM-të. Faktorët kryesor që ndikuan pozitivisht në standardet kreditore ishin mbështetja nga FKGK-ja dhe ulja e kërkesës për kolateral. Në anën tjetër, faktorët që ndikua negativisht në standardet kreditore ishin pozita e likuiditetit të bankave, kufizimet në kapitalin e bankave që operojnë në vend si dhe qasja më e rezervuar e bankave për të pranuar rreziqe. Faktorët tjerë që ndikuan në standardet kreditore kishin lëvizje marginale pozitive dhe negative dhe kryesisht kanë të bëjnë me perspektiven e bankave në vend, qasjen në financim nga bankat në vend dhe presionin nga konkurrenca mes bankave.


Standardet kreditore në përgjithësi, në tremujorin e tretë të vitit 2024 pritet të mbesin të ngjashme me ato të aplikuara në tremujorin aktual (TM2 2023), si për NVM-të ashtu edhe për ndërmarrjet e mëdha. Mbështetja nga FKGK dhe perspektiva pozitive e bankave pritet të kontribuojnë pozitivisht në lehtësimin e standardeve kreditore. Në anën tjetër, faktorët tjerë, siç janë pozita e likuiditetit të bankave dhe ecuria e kredive me probleme, në rast të përkeqësimit të tyre mund të implikime më të theksuara negative në standardet kreditore të aplikuara. Faktorët tjerë pritet që të kenë lëvizje marginale pozitive apo negative në standardet kreditore, siç janë konkurrenca, qasja në financim nga bankat që operojnë në vend etj.

#### Kushtet dhe rregullat

Në tremujorin e dytë të vitit 2024, në përgjithësi, kushtet dhe rregullat e aplikuara nga bankat me rastin e dhënies së kredive për ndërmarrjet (kushtet e specifikuar për një kontratë të caktuar për kredi) mbetën kryesisht të pandryshuara për të dy kategoritë e ndërmarrjeve (grafiku 2). Konkretisht, lehtësim deri në një masë u aplikua në kërkesën për kolateral si për NVM-të ashtu edhe për ndërmarrjet e mëdha, ndërsa shënuar lehtësim marginal në kushtet dhe rregullat e aplikuara në madhësinë mesatare të kredisë për ndërmarrjet e mëdha. Në anën tjetër, pagesat përveç normës së interesit (kryesisht tarifatat dhe komisionet e ndryshme), mbetën të pandryshuara si për NVM-të

ashtu edhe për ndërmarrjet e mëdha. Kushtet dhe rregullat e aplikuara u ndikuan negativisht nga kufizimet në qasje në kapital nga bankat në vend, cilësisë kreditore, perspektivës në tregjet globale dhe kufizimeve në qasje në kapital të bankave amë.. Në anën tjetër, kushtet dhe rregullat e aplikuara u ndikuan pozitivisht nga mbështetja nga FKGK-ja dhe norma në rënie e EURIBOR-it

Grafik 2. Ndryshimet në kushtet dhe rregullat e aplikuara për ndërmarrjet




Gjatë tremujorit të ardhshëm (TM3 2024), në përgjithësi, kushtet dhe rregullat e aplikuara nga bankat pritet të mbeten të pandryshuara krahasuar me tremujorin aktual. Përfundim në këtë rast bënë kërkesa për kolateral, e cila ndryshe nga tremujori aktual ku kishte lehtësim të kushteve dhe rregullave, në tremujorin e tretë nuk pritet të ketë ndryshime. Kufizimet në kapitalin e bankave vendore, pozita e likuiditetit si dhe perspektiva e tregjeve globale janë identifikuar si faktor që mund të ndikojnë negativisht në kushtet dhe rregullat e kreditimit gjatë tremujorit të tretë, megjithatë këta faktorë priten të neutralizohen nga konkurrenca dhe mbështetja nga FKGK-së.

### Kërkesa për kredi

Gjatë tremujorit të dytë të vitit 2024, kërkesa për kredi nga ndërmarrjet shënoi rritje të lartë, si për segmentin e NVM-ve ashtu edhe për ndërmarrjet e mëdha. Kërkesë e lartë në këtë tremujor është e reflektuar gjithashtu në anketën paraprake, në të cilën anketë (TM1 2024) bankat kishin shprehur pritjet e tyre për TM2 2024 (grafiku 3).

Grafik 3. Ndryshimet në kërkesën për kredi nga ndërmarrjet dhe faktorët që kontribuan



Sipas rezultateve të anketës, ndryshimet në kërkesën për kredi nga ndërmarrjet u ndikuan kryesisht nga rritja e kërkesës për inventar dhe kapital punues dhe investimeve fikse. Cilësia e aplikacioneve të pranuar nga ndërmarrjet ishte më e përmirësuar gjatë TM2 2024, por krahasuar me tremujorin paraprak ndryshimet ishin marginale. Në përgjithësi, kishte përmirësim në cilësinë e aplikacioneve

të dorëzuara nga NVM-të, ndërsa cilësia e aplikacioneve nga ndërmarrjet e mëdha mbeti e pandryshuar.

Sipas anketës, gjatë TM2 2024 niveli i kredive jo-performuese për ndërmarrjet shënoi rritje. Pesë banka, dy prej të cilave me rëndësi sistemike, raportuan nivel më të lartë të kredive jo-performuese. Ndërsa katër bankat e tjera, dy prej të cilave me rëndësi sistemike, raportuan se niveli i kredive jo-performuese mbeti i pandryshuar.

Në tremujorin vijues, pritjet rritje e kërkesës për kredi, megjithatë kjo rritje pritjet të jetë dukshëm më e ngadalësuar si për NVM-të ashtu edhe për ndërmarrjet e mëdha. Ngadalësimi i kërkesës për kredi pritjet ti atribuohet kryesisht kërkesës për financim të investimeve fikse, ndërsa në masë më të ulët kërkesës për financim të inventarit dhe kapitalit punues.

Gjatë tremujorit të ardhshëm bankat presin që raporti i kredive jo-performuese ndaj gjithsej kredive për ndërmarrjet, të mbetet i pandryshuar. Të gjitha bankat, përjashtuar dy banka që janë josistemike dhe me peshë të ulët në gjithsej kreditimin, raportuan që niveli i kredive jo-performuese pritjet të mbetet i pandryshuar në tremujorin vijues.


## Kreditë ndaj ekonomive familjare

### Standardet kreditore

Standardet kreditore të aplikuara për ekonomitë familjare gjatë tremujorit të dytë të vitit 2024 u lehtësuan deri në një masë. Ky lehtësim u aplikua si për kreditë konsumuese ashtu dhe për ato për blerjen e shtëpive. Pritjet për tremujorin aktual, që ishin deklaruar nga bankat në anketën e kaluar (TM1 2024), rezultuan të ngjashme me vlerat aktuale, veçanërisht për kreditë për blerje të shtëpive (grafiku 4). Faktorët që ndikuan në lehtësim të standardeve kreditore përgjatë TM2 2024 ishin konkurrenca ndërbankare, perspektiva pozitive në tregun vendor dhe rritja e besueshmërisë ndaj kredimarrësve.

Në tremujorin e tretë të vitit 2024, standardet kreditore të aplikuara nga bankat pritjet të jenë më të shtrënguara, duke reflektuar kryesisht segmentin e kredive konsumuese. Faktori që pritjet të ketë ndikimin më të lartë në shtrëngim të standardeve kreditore në tremujorin vijues do të jetë rritja potenciale e kredive me probleme, kurse faktorët tjerë nuk priten të kenë ndikim të rëndësishëm në shtrëngim/lehtësim të standardeve kreditore.


Grafik 4. Ndryshimet në standardet kreditore të aplikuara për ekonomitë familjare dhe faktorët që kontribuan



## Kushtet dhe rregullat

Kushtet dhe rregullat për kreditë e reja për ekonomitë familjare u lehtësuan deri në një masë gjatë tremujorit të dytë të vitit 2024 si për segmentin e kredive konsumuese ashtu dhe të atyre për blerjen e shtëpive. Më konkretisht, rezultatet sugjerojnë lehtësim në shumën mesatare të kredisë, ndërsa lehtësim deri në një masë në maturitetin e kredisë dhe kërkesës për kolateral, për të dy kategoritë e kredive - atyre për blerje të shtëpive dhe atyre konsumuese. Në lehtësim të kushteve dhe rregullave për kreditë e reja ndikuan konkurrenca nga bankat tjera, perspektiva optimiste e bankave në vend dhe besueshmëria për kredimarrësit (grafiku 5).

Grafik 5. Ndryshimet në kushtet dhe rregullat e aplikuara për ekonomitë familjare



Për tremujorin e tretë të vitit 2024, bankat në përgjithësi nuk presin ndryshime sa i përket kushteve dhe rregullave për kredi për ekonomitë familjare. Më konkretisht, përveç normës së interesit, nuk priten ndryshime në maturitet të kredive, kërkesës për kolateral dhe pagesave tjera. Kurse, lehtësim deri në një masë do të ketë vetëm për madhësinë mesatare të kredisë.

## Kërkesa për kredi


Rezultatet e anketës për TM2 2024 sugjerojnë se kërkesa kreditore nga ekonomitë familjare ka shënuar rritje dukshëm më të lartë krahasuar me rezultatet e anketës në tremujorin paraprak (TM1 2024). Nëse e zërthejmë kërkesën kreditore sipas llojeve të kredive për ekonomitë familjare, niveli i kërkesës ishte më i lartë për kredi konsumuese, ndërsa si rritje kërkesa ishte më e theksuar për kreditë për blerje të shtëpive (grafiku 6).

Sipas deklarimeve të bankave, rritja e kërkesës për kredi konsumuese është nxitur nga nevoja për financim të shpenzimeve të konsumit dhe rritja e besueshmërisë konsumatore, përshkak të perspektivës më optimiste makroekonomike. Ndërkohë, rritja e kërkesës për kreditë për blerje të patundshmërive është mbështetur kryesisht nga perspektiva pozitive e tregut të patundshmërive.

Sa i përket cilësisë së aplikacioneve të pranuar nga ekonomitë familjare, cilësia e aplikacioneve për kredi konsumuese tregoj përmirësim deri në një masë për kreditë konsumuese, përderisa cilësia e aplikacioneve për kredi për blerje të shtëpive shënoi rënie të lehtë.

Bankat deklaruan përkeqësim të cilësisë së portfolios kreditore për ekonomitë familjare, dinamikë e ndikuar nga përgjigjet e katër bankave, dy prej të cilave me rëndësi sistemike, të cilat deklaruan rritje të raportit të kredive jo-performuese. Në anën tjetër, shtatë bankat tjera, tri prej të cilave me rëndësi sistemike, deklaruan se raporti i kredive jo-performuese mbeti i pandryshuar.

Grafik 6. Ndryshimet në kërkesën për kredi nga ekonomitë familjare dhe faktorët që kontribuuan




Në tremujorin e tretë të vitit 2024, bankat presin rritje të kërkesës për kredi nga ekonomitë familjare, të nxitur kryesisht nga kreditë konsumuese, që kanë pjesëmarrjen më të lartë në gjithsej kreditë ndaj segmentit të ekonomive familjare, duke u ndikuar nga besueshmëria e konsumatorëve dhe nevoja për financimin e shpenzimeve të tjera familjare. Gjithashtu, parashihet një rritje e kërkesës, por në nivel më të ulët për kreditë për blerje të shtëpive, të mbështetur nga pritshmëritë për përmirësim në tregun e pasurive të patundshme.

Bankat presin përmirësim deri në një masë në cilësinë e aplikacioneve të pranuar për kredi si për blerje të shtëpive poashtu edhe ato konsumuese. Sa i përket cilësisë së portfolios kreditore të ekonomive familjare, nëntë nga njëmbëdhjetë bankat nuk presin ndonjë ndryshim në raportin e kredive jo-performuese, ndërsa dy banka, njëra prej të cilave me rëndësi sistemike presin përkeqësim deri në një masë të raportit të kredive jo-performuese.

### Financimi

Gjatë tremujorit të dytë të vitit 2024, qasja në financim nga bankat rezulton të jetë më e ulët krahasuar me përgjigjet në tremujorin paraprak. Bankat deklaruan rritje më të ulët të financimit, pavarësisht rritjes së depozitave të ekonomive familjare. Në anën tjetër është deklaruar rënie e financimit prej depozitave të ndërmarrjeve dhe financimit nga tregu i parasë ndërbankare (grafiku 7). Sa i përket maturitetit, bankat deklaruan se financimi afatshkurtër është rritur më ngadalë ndërsa financimi afatgjatë mbi një vit shënoi një rritje më të lartë.

Grafik 7. Ndryshimet në financimin e sektorit bankar



Gjatë tremujorit të ardhshëm, në përgjithësi bankat presin rritje dukshëm më të lartë të financimit, kryesisht nga rritja e pritur e depozitave nga të dy segmentet, ekonomitë familjare dhe ndërmarrjet. Poashtu gjatë tremujorit të tretë të këtij viti bankat presin rritje të financimit me maturitet

afatshkurtër, ndërsa financimi afatgjatë pritet të mbetet më stabil, pa ndryshime të theksuara (grafiku 7).

## Rezultatet e pyetjeve të fokusuara

Pyetësi i anketës për tremujorin e dytë të vitit 2024 është pasuruar me katër pyetje shtesë për të identifikuar rreziqet potenciale në sektorin bankar, si dhe modalitetet e kreditimit dhe analizimin e orientimit të ofertës dhe kërkesës kreditore sipas segmenteve të disagreguara të sektorëve ekonomik.

Pyetësi i anketës së realizuar në TM2 2024 ka për qëllim matjen e sentimentit të bankave rreth zhvillimeve kryesore dhe sfidave të sektorit financiar në tremujorin e ardhshëm dhe tërë vitin 2024. Ndikimi i kampanjave të bankave – kryesisht për kredi deri në 50,000 - 60,000 euro pa hipotekë, në kërkesën për kredi nga ekonomitë familjare si dhe qëllimi final i përdorimit të kredive konsumuese nga ekonomitë familjare (siq mund të jenë financimi për patundshmëri, veturë, renovim apo qëllime tjera) si dhe menaxhimi i rrezikut të likuiditetit ishin pyetjet shtesë që BQK ka parashtruar ndaj bankave përmes kësaj ankete. Në përgjigjet e tyre, bankat deklaruan se kampanja kreditore për dhënie të kredive në vlerën e cekur pa hipotekë përgjithësisht ka pasur efekt pozitiv në rritjen e kërkesës për kredi nga ekonomitë familjare. Megjithatë disa banka për shkak të kufizimeve të brendshme, kanë vendosur tavan më të ulët të shumës së kredisë pa hipotekë. Kurse, në pyetjen se cili rezulton të jetë qëllimi final i kërkesës së rritur të kredive konsumuese, bankat theksuan se nevojat për shpenzime personale, renovim dhe blerje të veturave kanë kontribuar në rritje të kërkesës për kredi konsumuese. Sa i përket pyetjes rreth dimensionit të likuiditetit, bankat deklaruan për qasje të kujdesshme në menaxhimin me likuiditetin, duke raportuar nivel të qëndrueshëm të indikatorëve kyç dhe duke deklaruar se nuk presin vështirësi në ruajtjen e likuiditetit në pjesën e mbetur të vitit 2024.

Përgjigjet në pyetjet rreth kreditimit sipas segmenteve të disagreguara të sektorëve ekonomik njoftojnë mbi kahjen e financimit të ekonomisë që bazohen apo reflektojnë edhe dinamikat në këta sektorë të caktuar ekonomik. Gjatë tremujorit të dytë të vitit 2024, standardet kreditore kishin ndryshime marginale të papërfillshme pothuajse në të gjithë sektorët ekonomik. Përrjashtim bënë sektori i prodhimit, ku kishte lehtësim të standardeve kreditore dhe ai i ndërtimtarisë, ku kishte shtrëngim deri në një masë të standardeve kreditore. Kushtet dhe rregullat u shtrënguan deri në një masë për sektorin e ndërtimtarisë, ndërsa mbeten të pandryshuara për sektorin e prodhimtarisë, shërbimeve, të patundshmërisë dhe atë të tregtisë. Në anën tjetër, kërkesa për kredi shënoi rritje gjatë kësaj periudhe, me sektorin e tregtisë që përfaqësoi kërkesën më të lartë për financim, ndjekur nga sektori i patundshmërisë dhe ai i prodhimit.

Sipas rezultateve të anketës, gjatë tremujorit të tretë bankat pritet të bëjnë ndryshime të vogla-shtrëngime marginale në ofertën kreditore për të gjithë sektorët ekonomik të përfshirë. Kushtet dhe rregullat, pritet të mbeten të pandryshuara, me përjashtim të sektorit të ndërtimit, për të cilin pritet të ketë shtrëngime marginale. Në të njëjtën periudhë, kërkesa për kredi pritet të rritet deri në një masë për sektorin e tregtisë, prodhimit dhe shërbimeve, ndërsa për sektorin e patundshmërive pritet rritje e kërkesës në nivel më të ulët.

## Pritjet për Inflacionin

Me qëllim të avancimit të kapaciteteve analitike dhe duke u bazuar në praktikat më të mira rajonale dhe më gjerë, BQK anketon institucionet financiare në vend. Kjo ndodhë duke u mbështetur në hipotezën se institucionet financiare bartin praktikat më të mira nga bankat amë dhe kanë ekspertizën e duhur për të projektuar dinamikat e inflacionit. Nga tremujori i tretë i vitit 2019, AKBK është pasuruar edhe me pyetje shtesë, që adresojnë pritjet e bankave komerciale për zhvillimet e

çmimeve në vend. Kjo ndihmon në plotësimin e publikimeve tona në aspektin e analizimit, modelimit dhe parashikimit.

Në pyetëtorin e fundit, përveç deklaramentit të bankave lidhur me vlerësimet që kanë për nivelin e inflacionit në tremujorin e dytë, pyetëtori adreson edhe pritjet e bankave për tremujorin e tretë të vitit 2024 si dhe për vitin 2024 në përgjithësi. Anketa shërben gjithashtu edhe si një mjet për identifikimin e faktorëve specifik që potencialisht mund të ndikojnë në pritjet e bankave për nivelin e inflacionit.

## Metodologjia

Pritjet e inflacionit luajnë të paktën dy role të rëndësishme. Së pari, ato ofrojnë një statistikë përmbledhëse kuantifikuese për shkallën e inflacionit në të ardhmen, dhe së dyti, mund të përdoren për të vlerësuar besueshmërinë e objektivit të inflacionit të vendosur nga bankat qendrore.

Rëndësia e pritjeve të inflacionit është më e lartë për vendet që kanë adoptuar strategjinë e shënjestrimit të inflacionit. Për këto vende, pritjet e inflacionit, ndër të tjera, shërbejnë edhe si një tregues i besueshmërisë së publikut ndaj bankës qendrore. Nëse besohet se banka qendrore do të reagojë për të arritur objektivin, atëherë edhe pritjet e agjentëve ekonomik lidhur me shkallën e inflacionit do të ishin më pranë objektivit.

Pritjet e inflacionit janë të rëndësishme edhe për bankat të cilat nuk posedojnë politikë monetare, duke qenë se ato shërbejnë si informacion shtesë-input i rëndësishëm në përcaktimin e çmimeve dhe pagave, si dhe në procesin e modelimit dhe parashikimit. Për më tepër, pritjet e inflacionit ndikojnë në kërkesën agregate, që më pas ndikon ecurinë e inflacionit.

Për dallim nga inflacioni aktual i cili matet në mënyrë të drejtpërdrejtë, pritjet për inflacionin vlerësohen sipas metodave të tërthorta. Ndër metodat më të përdorurat është metoda e anketimit të agjentëve ekonomikë: konsumatorëve, bizneseve, bankave komerciale, etj. BQK, për herë të parë, ka filluar me vlerësimin e pritjeve për inflacionin në tremujorin e tretë të vitit 2019, fillimisht me bankat komerciale.

Vlerësimet që merren nga bankat komerciale janë të formës sasiore, të shoqëruara edhe me shpërndarjen e probabilitetit. Pritjet për inflacionin vlerësohen për horizonte të ndryshme kohore, duke filluar me vlerësimet për tremujorin aktual dhe duke vazhduar me pritjet për tremujorin e ardhshëm si dhe për gjithë vitin aktual. Procesi i mbledhjes së informacionit përmes anketave pasohet nga procesi i sistemimit, përpunimit dhe agregimit të të dhënave për të gjetur mesataren e pritjeve të inflacionit nga bankat komerciale.

## Përmbledhja e rezultateve

Sipas anketës së realizuar në korrik të vitit 2024, bankat presin që niveli i inflacionit në tremujorin e tretë të vitit 2024 të mbetet i pandryshuar nga tremujori paraprak. Për gjithë vitin 2024, ato parashikojnë që niveli i inflacionit të jetë 2.7 përqind. Kjo tregon se pritjet e bankave për inflacionin kanë mbetur të pandryshuara nga anketa e kaluar, ku gjithashtu kishin parashikuar një nivel inflacioni prej 2.7 përqind për vitin 2024.

Tabela 2. Pritja e inflacionit nga bankat, ndryshimi vjetor në përqindje

Bankat	TM2 2024	TM3 2024	2024
1	2.4%	2.6%	2.5%
2	2.4%	1.9%	2.1%
3	2.1%	1.6%	2.1%
4	3.6%	3.5%	3.5%
5	2.4%	2.5%	2.8%
6	2.4%	3.2%	2.8%
7	2.3%	2.8%	3.9%
8	2.2%	0.2%	1.2%
9	2.2%	2.3%	3.1%
10	2.6%	3.0%	3.1%
11	2.3%	2.3%	2.2%
<b>Mesatarja</b>	<b>2.4%</b>	<b>2.4%</b>	<b>2.7%</b>

Burimi: Bankat komercial dhe kalkulumet e BQK-së.


Figura 8 ilustron shpërndarjet e raportuara të probabilitetit, duke treguar një siguri relativisht të lartë në lidhje me rezultatin e ardhshëm të inflacionit. Shpërndarja e probabilitetit të bankave është e përqendruar në inflacionin e pritur.

Në komentet e tyre cilësore, bankat kanë përmendur disa faktorë kyç që kanë ndikuar në shkallën e inflacionit, përfshirë rënien e çmimeve në tregjet ndërkombëtare (faktor i rëndësishëm për ekonominë e Kosovës për shkak të varësisë së lartë nga importet), si dhe politikat globale antiinflacioniste dhe ngadalësimin e rritjes së ekonomisë globale.

Në anën tjetër, rreziku për rritjen e inflacionit mbetet ende i lartë për shkak të faktorëve gjeopolitik, veçanërisht luftës në Ukrainë, pasi që furnizues të rëndësishëm të lëndëve të para janë Rusia dhe Ukraina. Bankat gjithashtu kanë shprehur se presin që me uljen e normave të interesit nga BQE do të ndikohet potencialisht rritja e presioneve inflacioniste. Presionet e brendshme për rritjen e pagave, si dhe shpenzimet e diasporës gjatë verës, pritet të kontribuojnë në rritjen e konsumit dhe, për pasoj, në rritjen e çmimeve.

Si përfundim, bankat presin një ngadalësim të rritjes së inflacionit gjatë vitit 2024. Të dhënat nga Agjencia e Statistikave të Kosovës deri në gusht të vitit 2024 tregojnë për një ngadalësim të normës së inflacionit (norma mesatare 2.1 përqind). Megjithatë, pritjet për ngadalësim mund të ndikohen negativisht nga pasiguria e zhvillimeve globale dhe ndjeshmëria ndaj tyre.

**Grafik 8. Probabiliteti i inflacionit për TM3 2024 (boshti-x: pritjet e inflacionit, ndryshimi vjetor në përqindje; boshti-y: probabiliteti)**



Burimi: Bankat komercial dhe kalkulumet e BQK-së.



Rr. Garibaldi, nr.33, 10000 Prishtinë,  
Republika e Kosovës  
Tel: +383 38 222 055; Fax: +383 38 243 763  
Web: [www.bqk-kos.org](http://www.bqk-kos.org)